



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:071156

Datë: 14.08.2019

Numri i dokumentit: 00509257

P.nr.891/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me procesmbajtësen Nushe Kadrija – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit B.G. nga Gjakova, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë- Departamenti i Përgjithshëm me numër PP.nr.1701/18 të datës 17.12.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, publik, **me datë 14.08.2019** në prezencën e Prokurores së shtetit Mone Sylja, të akuzuarit B.G., në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 03.09.2019 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

B.G., nga i ati Zh., e ëma N., e gjinisë B.rahimi, data e lindjes..., në Pejë, tani me vendbanim në Gjakovë, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, egjiptian-shtetas i Republikës së Kosovës, numër personal....

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datën 09.11.2018, rreth orës 17:45 minuta, në Gjakovë në rrugën “B.Q.” tek p. e vogël, i shkakton lëndime trupore, të dëmtuarit S. (M.) C. nga Gjakova, në atë mënyrë që deri sa i dëmtuari ndërhyjë për të ndërprerë sulmin me thikë të akuzuarit, në drejtim të personit M.B., të cilën i dëmtuari e kishte shok, i akuzuari me thikë duke tentuar që ta godas M., i cili i shmagnet goditjes, ndërsa i dëmtuari duke e ndërprerë sulmin i del para të akuzuarit, ashtu që i akuzuari të dëmtuarin e godet me thikë në bark, me ç’ rast i shkakton lëndime trupore lëndime të konstatuara dhe të përshkuara hollësisht në ekspertizën mjeko-ligjore të Dr. F.D. të datës 13.12.2018.

Me këto veprime ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 41, 42, 49, 50, 51, 52, 73, 74 dhe nenit 188 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së, të akuzuarit ia shqipton:

D Ë N I M I N M E K U S H T

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale.

I dëmtuari S.(M.)C. nga Gjakova, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

URDHËROHET Shërbimi Sprovues i Kosovës në Gjakovë, që të mbikëqyrë dhe ta ekzekutojë Dënimin me Kusht, ashtu që **Obligohet** i akuzuari B.G. që të mbajë kontaktin me Shërbimin Sprovues të Kosovës në Gjakovë.

Ndaj të akuzuarit shqiptohet edhe

D Ë N I M I P L O T Ë S U E S

Ashtu që konfiskohen: 1 (një) një mjete i mprehtë thikë, si objekte të veprës penale.

I akuzuari B.G. lirohet nga shpenzimet e procedurës penale dhe të njëjtat bien në llogari të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj Gjykate ka ngritur aktakuzën PP.nr.1701/18 të datës 17.12.2018, kundër të akuzuarit B.G. nga Gjakova, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK-. Gjatë shqyrtimit fillestar Prokurorja e shtetit Mone Syla ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit B.G. andaj, ka propozuar që i njëjti të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari B.G., gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se: e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, shton se jam penduar shumë për këto veprim pasi që S. më ka shty për gjoksi pasi që unë kam dashur që të përleshem me M. por e kam goditur me thikë S., prandaj i kërkoj falje të njëjtit dhe i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të këtilla.

Prokurorja e shtetit Mone Syla, duke dhënë mendim rreth pranimin të fajësisë ka deklaruar se: nuk e kundërshtojë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që i njëjti pranimin e fajësisë e bën me vetëdije dhe vullnet të plotë pa presion, i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë po ashtu pranimi i fajësisë mbështetet edhe provat dhe në faktet që janë bashkangjitur aktakuzës andaj i propozoi gjykatës që i njëjti të shpallet fajtorë për veprën penale dhe të dënohet sipas ligjit dhe të obligohet në pagesën e shpenzimeve të procedurës penale dhe po ashtu gjatë matjes së dënimit gjykata i merr për bazë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe po ashtu rënduese nëse gjen.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi është vërtetuar se i akuzuari B.G., me datën 09.11.2018, rreth orës 17:45 minuta, në Gjakovë në rrugën "B.Q." tek p. e v.l, i shkakton lëndime trupore, të dëmtuarit S.(M.)C. nga Gjakova, në atë mënyrë që deri sa i dëmtuari ndërhyjnë për të ndërprerë sulmin me thikë të akuzuarit, në drejtim të personit M.B., të cilën i dëmtuari e kishte shok, i akuzuari

me thikë duke tentuar që ta godas M., i cili i shmaget goditjes, ndërsa i dëmtuari duke e ndërprerë sulmin i del para të akuzuarit, ashtu që i akuzuari të dëmtuarin e godet me thikë në bark, me ç' rast i shkakton lëndime trupore lëndime të konstatuara dhe të përshkruara hollësisht në ekspertizën mjeko-ligjore të Dr. F.D. të datës 13.12.2018.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari e tij, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 dhe 74 të KPRK-së të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: është babai i tre fëmijëve, në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt, pendimin e tij duke shprehur keqardhje për rastin e ndodhur, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të këtilla, do të jetë më i kujdesshëm si dhe faktin që më parë nuk ka qenë i dënuar. Ndërsa si rrethana posaçërisht lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, faktin se i akuzuari është i gjendjes së dobët ekonomike, është përfitues i ndihmës sociale dhe është mbajtës i vetëm familjes prej 5 anëtarësh. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese për të akuzuarin gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin për mbikëqyrjen dhe ekzekutimin e dënimit me kusht është marrë konform nenit 58 të KPRK-së, duke urdhëruar që dënimin me kusht ta mbikëqyr dhe ta ekzekutojë Shërbimi Sprovues i Kosovës në Gjakovë, ngase gjykata konsideron se integrimi i të akuzuarit në shoqëri ose përmeshja e dënimit me kusht të shqiptuar nga gjykata arrihet më së miri përmes mbikëqyrjes nga ana e Shërbimit Sprovues të Kosovës në Gjakovë.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt juridiko- civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 par.2 të KPP-së.

Vendimi mbi lirimin nga shpenzimet e procedurës penale për të akuzuarin është marr konform nenit 453 par.4 të KPP-së, për faktin se gjykata konsideron se me pagimin e shpenzimeve do të rrezikohej gjendja materiale e të akuzuarit duke marr për bazë faktin se i akuzuari është pa punë, mbajtëse i vetëm i familjes, i gjendjes shumë të varfër ekonomike si dhe fakti se është përfitues i ndihmave sociale ku gjatë shqyrtimit fillestar edhe ka prezantuar librezën Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, me numër 2003/23.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr.891/18, me datë 14.08.2019

Procesmbajtësja,
Nushe Kadrija

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Mentor Bajraktari

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.